Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**26.10.2023**	**14.11.2023**	**2023/0811**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.10.2023, OE "G.S.G SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0811, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "G.S.G SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me targa per regjistrimin e automjeteve" me nr. të prokurimit: "214-22-12927-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0811 i dt:19.10.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Me date 28.09.2023 kemi pranuar permes e-prokurimit Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues per kete

aktivitet prokurimit permes te cilit kemi kuptuar se eshte rekomanduar per dhenie te kontrates Grupi i OE Ego Elsa &

Rade Koncar dhe gjithashtu permes letres standarte kemi kuptuar edhe arsyet e pretenduara nga AK-es per eleminimin

tone.

Pretendim Ankimor Nr: 1

Permes qasjes ne shkresat e lendes kemi kuptuar se UD i Zyrtarit Pergjegjes te Prokurimit z. Agim Islami ka marre

vendim per dhenie te kontrates ne kundershtim flagrant te procedurave te perzgjedhjes se pjesmarresve dhe dhenies se

kontrates te percaktuara me Neni 56, 59 & 60 te LPP-se dhe Nenin 39, 40 & 45 te Rregullores Nr.001/2022 per

Prokurim Publik duke vleresuar vete personalisht tenderit dhe duke nxjerr vendim arbitrar per te shpallur fiutes nje OE

per te cilin eshte e faktuar se eshte i papergjegjshme dhe gjithashtu eshte me i shtrenjt se oferta jone per mbi 200,000.00

euro. Sqarojmë se me asnjë dispozitë ligjore të LPP-së dhe Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik nuk

përcaktohet kompetenca apo detyra që zyrtari përgjegjës i prokurimit të vlerësoj dhe ekzaminoj tenderet se a i kanë

plotësuar apo jo kriteret e dosjes Opertorët Ekonomik. I njëjti de-facto ka shërbyer si anëtar i komisionit vlerësues dhe

atë si "anëtarë i vetëm", duke injoruar rekomandimin e Komsionit Vlerësues ashtu që ka bërë vlerësim dhe ekzaminim të

ofertave të Operatorëve Ekonomik në kundërshtim me kompetencat që ka me Rregulloren nr. 001/2022 dhe dispozitat e

Ligjit për Prokurimin Publik. Kjo për faktin se kur ka arsyetuar se pse ka marrë vendim që të shpërblej me kontratë

operatorin ekonomik të rekomanduar me kontratë, ka deklaruar se pas ekzaminimit të ofertave rezulton se ka operator

ekonomik të përgjegjshëm. Pra, i njëjti ka kryer një detyrë të cilën nuk e ka kompetencë, e kjo është ekzaminimi dhe

vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomik. Ky tejkalim i kompetencave nga ana e zyrtarit përgjegjës përbën vepër

penale të Keqpërdorimit të Detyrës Zyrtare, sepse ka tejkaluar kompetencat e tij për qëllim te caktuar qe t'i sjell përfitim

të paligjshëm një operatori ekonomik i cili është i papërgjegjshëm dhe në anën tjetër ka për qëllim të na dëmtoj neve si

Operator Ekonomik të përgjegjshëm dhe buxhetin e Republikës së Kosovës për një shumë prej mbi 200,000.00 Euro.

Pretendim Ankimor Nr: 2

Grupi i Oe Ego Elsa & Rade Koncar te rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem sepse:

Sipas Raportit te Forenzikes me Nr. Ref: AKF/2023-028 dt. 28.02.2023 (pika 3, faqe14 nga 40) eshte konstatuar se

mostra/targa e evidentuar me shifren nr.444 nuk e permbush kerkesen e dosjes se tenderit ne raport me Fijen Virtuale

sepse standarti sipas kerkeses se dosjes se tenderit eshte qe gjeresia te jete 10mm me tolerance /-1mm ndersa nga matjet

rezulton se gjeresia e fijes virtuale nga mostra me shifren nr.444 eshte 8.47mm, qe do te thote se e njejta nuk e ploteson

kerkesen e DT-es, pasi që tejkalon tolerancën e lejuar për pothujase 1mm shtesë. Autoriteti Kontraktues në kundërshtim

me këtë provë materiale – Raportin e Forenzikës dhe në kundërshtim të plotë te dispozitave te LPP-se, ka vendosur që

Operatori i rekomanduar për kontratë përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit në raport me fijen virtuale gjithashtu vlen

te theksohet se edhe gjate fazes se pare te vleresimit te ofertave jane fshehur qellimshem mangesite e konstatuara (per

OE Ego Elsa & Rade Koncar) nga komisioni vleresues paraprak dhe nga zyrtari pergjegjes i prokurimit . Autoriteti

Kontraktues me asnjë fjali nuk ka arsyetuar pse nuk ka marrë parasysh fare konstatimet e dhëna nga Raporti i

Forenzikës lidhur me faktin se ky raport e konstaton qartë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i

papërgjegjshëm.

Pretendim Ankimor Nr: 3

Autoriteti Kontrakues pretendon se ne nuk kemi permbushur kerkesat mbi Mundesite Teknike dhe Profesionale nga pika

2, ku kerkohet siq citoj:

Kerkesa 2; Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në

përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet mostra dhe përshkrimi i specifikimeve

teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e

veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të

Dosjes së tenderit.

Deshmia 2; Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike- MOSTRA e targave dorëzohen fizikisht para hapjes se

ofertave, në një zarf të mbyllur.

Ne ne oferten tone kemi dorezuar mostren e kerkuar se bashku me pershkrimin e specifikimeve teknike dhe

konfirmojme se mostra eshte nje targe e rendomte e cila eshte ne perdorim dhe mostra eshte ne harmoni me kualitetin e

materjaleve te specifikuara ne Aneksin 1 te DT-se. Konsiderojme se pretendimi i AK-es se kinse mostra e dorezuar

duhet te jete 01-999-AD dhe jo 01-444-AD eshte pertej llogjikes normale sepse nuk do te prodhohet vetem targa 01-

999-AD specifikisht, por prodhimi i targave do te behet per te gjitha kombinimet dhe per te gjitha shkronjat dhe germat

qe jane tek skicat dhe dizajni i targave dhe gjithashtu duhet ti rikujtojme AK-es se ne aktivitetet paraprake ka pasur

shume OE qe kane dorezuar mostra me kombinime te ndryshme dhe asnjehere me pare nuk ka pasur nje pretendim te

tille. Autoriteti Kontraktues nuk ka argumentuar se çfarë rendesie ka kombinimi i numrave dhe shkronjave në mostrën e

dorëzuar. Siç e din edhe Autoriteti Kontraktues, për realizimin e suksesshëm të kontratës nuk janë të rëndësishme

kombinimet e shkronjave dhe numrave në targa/mostër, por kualiteti i mostrës i cili është dëshmuar nga ana jonë se i

plotëson kriteret e kërkuara të dosjes së tenderit dhe parametrat e kërkuara. Andaj, kjo nuk mund të jetë arsye eliminimi

në rastin konkret.

Me tutje, sa i perket pretendimit te AK se kinse fija virtuale nuk eshte konform kerkeses se dosjes se tenderit ju

sqarojme se ky pretendim eshte i paqendrueshem sepse ne baze te raportit te forenzikes eshte konstatuar rregullsia e fijes

virtuale ndersa sa i perket raportit te Fakultetit Teknik konsiderojme se te njejtit nuk kane as pasije per te shikuar fijen

virtuale e jo me qe te bejne matjen e sakt te saj andaj jemi te bindur se keto pretendime nuk qendrojne dhe jane te

pabaza. Mendojme se AK-es eshte dashur qe minimalisht te kerkoj nje sqarim per keto raporte

kontradiktore nga te dy

institucionet perkatese dhe jo te marr si te mireqene vetem ate raport qe i konvenon. Eshte parim se ne rastet kur dy

ekspertiza ose raporte jane kontradiktore njera me tjetren, duhet te caktohet ose behet matja ne nje laborator te trete, ku

perfundimisht permes nje testimi te ri do te definohej se cili nga raportet eshte i sakte dhe i drejte. Nese shikohen

fotografite e testimeve nga Fakulteti i Inxhinerise Mekanike shihet se ky fakultet nuk ka aparaturen e duhur per testime

te tilla dhe testimi eshte bere me veprime mekanike duke bere matje me dore dhe jo me pajisje precizse kompjuterike te

cilat do te mund te konstatonin saktesine e dimensioneve te kerkuar.

Gjithashtu duhet konstatuar fakti se vendimi i OSHP me numer 2023/0167 ne faqen 3 dhe 4 te tij, ka obliguar AK-es qe

te dergoj ne analiza ne laborator te licencuar ose fakultet, vetem materialin baze te mostres siq citojme: "Si rezultat i

mos matjes se mostrave konform kerkes se Dosjes se Tenderit, PSH vendosi qe kete aktivitet te prokurimit ta kthej ne

ri-vleresim, dhe obligon AK qe keto mostra ti dergoj ne ndonje laborator apo ne fakultet te teknikes, me kerkese qe

matja e ketyre mostrave te behet sipas kerkeses se DT qe d.t.th materiali baze i mostres". Pra veprimi qe AK ka bere,

per te derguar mostrat per matjen e te gjihta permasave edhe njehere, eshte ne kundershtim me vendimin e OSHP-se

dhe eshte bere vetem me nje qellim per te ndryshuar rezultatit paraprak te matjeve te bera nga Agjencia e Forenzikes ku

te njejtit kishin konstatuar se mostra/targa e evidentuar me shifren nr.444 (OE Ego Elsa & Rade Koncar) nuk e

permbush kerkesen e dosjes se tenderit ne raport me Fijen Virtuale sepse standarti sipas kerkeses se dosjes se tenderit

eshte qe gjeresia te jete 10mm me tolerance /-1mm ndersa nga matjet rezulton se gjeresia e fijes virtuale nga mostra me

shifren nr.444 eshte 8.47mm. Gjithashtu ne si OE kemi insistuar per sqarim nga ana e Fakultetit Teknik dhe per deshmi

mbi matjet e kryera sepse jemi te bindur qe ata kane mashtruar dhe kane manipuluar matjet e mostrave sepse te njejtit

nuk kane paisje adekuate per te kryer matjen e fijes virtuale, por te njejtin kane refuzuar qe te na japin sqarime dhe

detaje per matjet e kryera. OSHP është përkujdesur që kur ka dhënë sqarim se çka duhet të dërgoj për matje Autoriteti

Kontraktues ta sqaroj në mënyrë të posaçme se duhet dërguar vetëm materiali bazë dhe për këtë OSHP e ka vën theksin

në fjalinë "d.m.th materiali baze i mostres", mirëpo Autoriteti Kontraktues qëllimisht ka dërguar për matje të gjitha

përmasat edhe njëherë me të vetmin qëllim për të ndryshuar rezultatet paraprake të matjeve të bëra nga Agjencia e

Forenzikës dhe kështu t'i mundësohet kunderligjshem Operatorit të rekomanduar për kontratë të jetë fitues i këtij

aktiviteti të prokurimit.

Pretendim Ankimor Nr: 4

Autoriteti Kontrakues pretendon se ne nuk kemi permbushur kerkesat mbi Mundesite Teknike dhe Profesionale nga pika

3, ku kerkohet siq citoj:

Kerkesa 3; Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe

karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.

Deshmia 3; Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e

konsideron te nevojshme).

Ne ne oferten tone kemi dorezuar Test-Raportin me nr: ref: 1140-2/1894783071/20 dt.22.09.2020 të lëshuar nga

DEKRA Automobile GmbH i cili është laborator i akredituar për të kryer testime dhe certifikime për standardin ISO

7591, dhe ne këtë raport është e shkruar qarte se mostra është testuar konform pikave 6.1, 6.2, 7.1, 7.2, 8, 9, 10, 11, 12,

13, 14, 15 & 16 të standartit ISO 7591:1982, dhe gjithashtu pas keti testimi ne jemi pajisur edhe me qertifikate permes

se ciles konfirmohet se mostra jone i permbushe te gjitha kerkesat e standartit Iso 7591:1982. Per te sqaruar edhe me

teper kete pretendim absurd te AK-es ne kemi kërkuar edhe një sqarim nga Dekra Automobile GMBH, dhe na është

konfirmuar se test raporti me nr: ref: 1140-2/1894783071/20 konfirmon gjithashtu edhe përputhshmërinë e shtresës me

stampim te nxehtë ashtu siç kërkohet ne piken 10 te Aneksit 1. Po ju citojm pergjigjen e Dekra Automobile GmbH ne

lidhje me test raportin e dt.22.09.2020 me nr: ref: 1140-2/1894783071/20:

"ISO has no special requirements for the font and the colors of the letters. The lighting technology and colorimetric

information/requirements listed in the standard only apply to the reflective film. If one font and one color of letters (hot

stamping foil) compatible, generally folloës from the others testing of the standard, i.e. from sections 8 to 16. And since

the report shoës the standard conformity of the signs ëith ISO 7591 is certified, is at the same time also certified that

the font and the coloring also automatically conform to the standard are equivalent to".

Nese Autoriteti Kontraktues ka dyshime lidhur me keto teste dhe sqarime, ka mundur t'i drejtohet Dekra GmbH per

sqarime sepse ju konfirmojme me pergjegjesi te plote se ky test raport dëshmon që prodhimi i targave (mostrave) për

regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe

specifikimeve teknike te dosjes se tenderit. Konsiderojme se pretendimi i AK-es eshte trajtuar ne fazen paraprake te

vleresimit po te njejtin nuk e lexojn dhe qellimshem e injorojn sqarimin e dhene nga Dekra Automobile GMBH dhe kjo

vërehet se edhe me rastin e kërkesës për rishqyrtim është injoruar në tërësi raporti i testimit i DEKRA dhe sqarimi

plotësues i dhënë nga kjo e fundit.

Pretendim Ankimor Nr: 5

Grupi i OE-ve Erich Utsch AG; Horn & Co. Kosova Shpk eshte i papergjegjshem sepse i njejti nuk ka permbushur

kerkesat mbi Mundesite Teknike dhe Profesionale nga pika 2 , sepse mostra e dorezuar nuk posedon shenjen RKS tek

numrat dhe shkronjat dhe nuk posedon daten e porosise. Gjithashtu nuk kane dorezuar Sigurimin e Tenderit konform

LPP-se sepse ka dorezuar nje sigurim nga nje institucion i cili nuk eshte i licencuar nga BQK-ja dhe eshte ne

kundershtim me Nenin 28.5 te Rregullores Nr.001/2022 per Prokurim Publik dhe ne kundershtim me Ligjin Nr. 05/L□045 per Sigurimet neni 5.

Pretendim Ankimor Nr: 6

Operatori Ekonomik Europrinty eshte i papergjegjshem sepse i njejti nuk ka permbushur kerkesat mbi Mundesite

Teknike dhe Profesionale nga pika 2 , sepse nuk ka dorezuar fare moster.

Pretendim Ankimor Nr: 7

Operatori Ekonomik IDK Konstruksion Shpk eshte i papergjegjshem sepse i njejti nuk ka permbushur kerkesat mbi

Mundesite Teknike dhe Profesionale nga pika 2 dhe 3 , sepse mostra e dorezuar nuk posedon daten e porosise dhe

gjithashtu test-raporti eshte ne kundershtim me kerkesat e DT-se sepse laboratori i prezantuar nuk eshte i akredituar per

standartin ISO 7591. Gjithashtu nuk kane dorezuar Sigurimin e Tenderit konform LPP-se sepse ka dorezuar nje sigurim

nga nje institucion i cili nuk eshte i licencuar nga BQK-ja dhe eshte ne kundershtim me Nenin 28.5 te Rregullores

Nr.001/2022 per Prokurim Publik dhe ne kundershtim me Ligjin Nr. 05/L-045 per Sigurimet neni 5.

Pretendim Ankimor Nr: 8

Grupi i OE-ve Cetkos LLC; Utal Spz.o.o eshte i papergjegjshem sepse i njejti nuk ka permbushur kerkesat mbi

Mundesite Teknike dhe Profesionale nga pika 3 , sepse test-raporti eshte ne kundershtim me kerkesat e DT-se sepse

laboratori i prezantuar nuk eshte i akredituar per standartin ISO 7591 perkatesisht nuk eshte i akredituar per te kryer

testime per pikat 6.1, 6.2 dhe 7 te standartit ISO 7591. Gjithashtu nuk kane dorezuar Sigurimin e Tenderit konform LPP□se sepse ka dorezuar nje sigurim nga nje institucion i cili nuk eshte i licencuar nga BQK-ja dhe eshte ne kundershtim me

Nenin 28.5 te Rregullores Nr.001/2022 per Prokurim Publik dhe ne kundershtim me Ligjin Nr. 05/L-045 per Sigurimet

neni 5.

Rrjedhimisht, nga argumentimi i bërë si më lartë konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitën e nenit

1 të Ligjit për Prokurimin Publik, me të cilën dispozitë është përcaktuar se qëllimi i ligjit është që të sigurohet që e

mira publike të realizohet me një kosto sa më optimale dhe të mos dëmtohet buxheti i Republikës së Kosovës. Me

vendimin e tillë të AK dëmtohet buxheti i Kosovës për më shumë se 200,000.00 Euro dhe rrjedhimisht shkelet haptazi

dhe me dashje kjo dispozitë ligjore.

Konsiderojmë se në veprimet e Autoritetit Kontraktues ka edhe elemente diskriminuese të parapra me nenin 7 të LPP□së , dhe kjo për arsye se AK me dashje nuk ka respektuar urdhrin e OSHP-së , të dhë në me vendimin e lartcekur që të

dërgohen për matje vetëm materiali bazë i mostrave, ku AK me qëllim ka dërguar për matje të gjitha përmasat në

mënyrë që të marrë një rezultat që i shkon për favor vetëm Oepratorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë .

Element tjetër diskriminues është se AK nuk ka pranuar të marrë sqarime shtesë ose veprime shtesë për të eliminuar

kontradiktat mes raportit të Forenzikës dhe raportit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekainike, ku para vetës AK ka dy

raporte që japin konstatime të ndryshme. Me këto veprime AK haptazi ka diskriminuar në favor të operatorit

ekonomik të rekomanduar për kontratë .

Me tuje, AK ka shkelur edhe dispozitën e nenit 59 të LPP-së për faktin se me këtë dispozitë është rregulluar qartë se

ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë ekskluzive e Komisionit Vlerësues. Në anën tjetër

zyrtari përgjegjës i prokurimit publik ka ndërmarrë veprime për ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve me të vetmin

qëllim që të mos marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Vlerësues për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit

dhe kështu të shpall fitues Operatorin e rekomanduar për kontratë . Këto veprime të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të

AK-së përbëjnë shkelje të nenit 59 dhe në të njëjtën kohë edhe vepër penale.

AK ka shkelur edhe dispozitat e nenit 60 dhe 69 të LPP-së , ku ka injoruar argumentet e lartcekura të cilat dëshmojnë

se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është operator ekonomik i papërgjegjshëm dhe se është dashur të

eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Duke pasur parasysh pretendimet e argumentuara, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit të

nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE G.S.G SH.P.K & KIG d.d

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së i dates 27.09.2023 dhe lenda te kthehet në RIVLERESIM dhe

gjjithashtu, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit,

njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së dhe te shmangen veprimet tendencioze dhe te qelimshme te

AK-es sepse te njejtat jane veprimet anti-ligjore

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

		a.Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L- 068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).

		b.Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	b.Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vertetimit nga administrata tatimore, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.

		c.Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë" për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, i cili duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	c.Vërtetimin nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vërtetimin nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës, është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës. b.Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje). b.Certifikata e TVSH-së (kopje).
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar a.Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi te kënaqshme Autoritetit kontraktues, se qarkullimi vjetor financiar i OE i realizuar në tri vitet e shkuara 2019-2020-2021 kanë qenë jo me pak se 3,000,000.00 €.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës (kopje).
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional 1.Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të kenë kontratë/a të përfunduara me sukses për furnizim me targa për regjistrim të automjeteve, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo me pak se 500,000.00 € , të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).

		2.Operatori ekonomik është i obliguar që për targat me të cilat ofertojnë duhen ta dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim, me dimensione 520 x 110 mm së bashku me përshkrimin e specifikimeve teknike. Nëse nuk dorëzohet mostra dhe përshkrimi i specifikimeve teknike te mostrës oferta nuk do te merret ne shqyrtim dhe do te konsiderohet oferte e pa përgjegjshme. Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë, por duhet jenë ne harmoni me kualitetin e materialeve për prodhimin e targave sipas specifikave teknike te dhëna ne Aneksin 1 të Dosjes së tenderit.	2. Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike- MOSTRA e targave dorëzohen fizikisht para hapjes se ofertave, në një zarf të mbyllur.
		3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.	3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)
		4. Laboratori/institute i cili leshon test raportin sipas kerkesen ne nenin 9.1 & 9.2 te pikes 3, duhet te jete i akredituar nga institucionet perkatse dhe te jete i pranuar/antarsuar së paku një nga këto organizatat: -Kooperimi Evropian për Akreditim (EA) - Kooperimi ndërkombëtar laboratorik për akreditim (ILAC) - Forumi ndërkombëtar për akreditim (IAF).	4. Çertifikatë ose dokument tjetër dëshmues (kopje) *AK rezervon te drejten qe te kerkoi origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme*)
		5.Dëshmi me të cilën dëshmohet që folia dhe ngjyra e shkronjave është kompatibile në pajtim me ISO 7591.	5. Çertifikatë ose dokument tjetër dëshmues (kopje), *AK rezervon te drejten qe te kerkoi*

			origjinalin e dokumentit me nese e konsideron te nevojshme).
		6.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 7591 për prodhimin e targave retro-reflektive për automjete motorike dhe rimorkio (Retro-reflective registration plates for motor vehicles and trailers).	6. Certifikatën valide ISO Standard 7591 (kopje)
		7.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 9001 për menaxhim cilësor te sistemeve (Quality manage systems)	7.Çertifikatë valide ISO 9001 (kopje)
		8.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 14001 për Sistemet e menaxhimit mjedisor (Environmental management systems).	8.Çertifikatë valide ISO 14001 (kopje)
		9. Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 27001 për menaxhim te sigurisë se informacionit (Information security management).	9. Çertifikatë valide ISO 27001 (kopje)
Ankesat	32.3	Shëno adresën e AK-së. Referoju nenin 1.1 ne FTD	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **G.S.G SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues përmes ankesës ka ngritur një numër të pretendimeve ankimore, të cilat pretendime në vazhdim do ti ndajmë në dy grupe, pretendimet ankimore të OE mbi arsyet e eliminimit të tij, si dhe pretendimet ankimorë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë. Vlen të theksohet se OE I rekomanduar për kontratë është me çmim më të lartë se OE ankues.

Pretendimi nr.1

OE ankues përmes ankesës pretendon se Arsyet e AK-së për eliminim të tij janë të pabaza.

Arsyet e AK-së për eliminim të OE janë se i njëjti ka ofruar raport të testimit nga DEKRA për ISO 7591, ndërsa lidhur me kërkesën për stampim të nxehtë ka ofruar raport nga ZAG, i cili raport thirret në raport të testimit nga viti 2018.

AK po ashtu ka konstatuar se mostrat e ofruar mbajnë numrat 01 444 AD, e jo 01 999 AD.

Po ashtu AK ka konstatuar se fija virtuale është më e madhe se ajo e lejuar në dosje të tenderit.

OE ankues pretendon se i njëjti ka ofruar raportin e testimit sipas ISO 7591 në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa sa i përket stampimit të nxehtë, citojmë :

"*...nga Dekra Automobile GMBH, dhe na është konfirmuar se test raporti me nr: ref: 1140-2/1894783071/20 konfirmon gjithashtu edhe përputhshmërinë e shtresës me stampim te nxehtë ashtu siç kërkohet ne piken 10 te Aneksit 1. Po ju citojm pergjigjen e Dekra Automobile GmbH ne lidhje me test raportin e dt.22.09.2020 me nr: ref: 1140-2/1894783071/20: "ISO has no special requirements for the font and the colors of the letters. The lighting technology and colorimetric information/requirements listed in the standard only apply to the reflective film. If one font and one color of letters (hot stamping foil) compatible, generally folloës from the others testing of the standard, i.e. from sections 8 to 16. And since the report shoës the standard conformity of the signs ëith ISO 7591 is certified, is at the same time also certified that the font and the coloring also automatically conform to the standard are equivalent to...*".

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, dosjes së tenderit dhe njoftimit mbi vendimin e AK-së, vlerësojmë se :

Në dosje të tenderit në specifikacion teknik është kërkuar stampimi i nxehtë, mirëpo dokumenti i kërkuar ka qenë : "*Certifikata dhe test raporti i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardet ISO 7591 i lëshuar nga një laborator i akredituar*.".

Pras siq shihet nga vet dosja e tenderit, askund në "dokumentin e kërkuar" nuk shënon se certifikata dhe raporti testimit duhet të kenë të dhëna/konfirmim të nxehtë, dhe është kërkuar vetëm raporti

testimit në pajtim me *me standardet ISO 7591 i lëshuar nga një laborator i akredituar,* kërkesë kjo e cila plotësohet nga OE ankues.

Po ashtu sa i përket fijës virtuale, kërkesa e dosjes së tenderit në FDT pika 9.1&9.2 ndër të tjera thotë: "*Mostra **nuk është e obligueshme** që ti kenë masat e veçanta të sigurisë*", andaj vlerësojmë se vija virtuale si masë e sigurisë nuk mundet TANI të përdoret si arsyetim për eliminim të OE ankes.

Po ashtu sa i përket arsyetimit të AK se mostra bart numrin 01 444 , e jo 01 999, kërkesa e dosjes po ashtu ka qenë që OE duhet të :"*dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim.*

Bazuar në këtë kërkesë të dosjes së tenderit konsiderojmë se mostra e OE është në pajtim me kërkesat e dosjes, pasi siç pretendon edhe OE ankues numri 01 999 nuk është i vetmi kombinim numrave me të cilën do të prodhohen targat.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Horn Kosova nuk mostrën e ofruar e ka pa shenjen rks, dhe se mostra nuk ka datë, eksperti shqyrtues nuk ka kapacitet teknik/profesional për të trajtuar këtë pretendim ankimorë dhe duhet mbështetur në raportet e testimit nga Fakulteti.

Sa i përket pretendimeve ankimorë kundrejt OE-ve të tjerë me çmim më të ulët se OE ankues, të cilët po ashtu janë eliminuar nga AK, mirëpo të njëjtit nuk kanë parashtruar ankesë në OSHP, konsiderojmë se të njëjtit kanë pranuar vendimin e AK-së për eliminimin e tyre, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimet ankimore kundrejt OE fitues, se OE fitues fijën virtuale sipas raportit të forenzikës e ka jashtë parametrave të kërkuar me dosje, eksperti sqaron se me vendim të OSHP-së pas raportit të forenzikës AK është obliguar të dërgoj mostrat prap për testim dhe raporti i forenzikës konsiderojmë se tanimë është nul (i pavlefshëm).

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si Pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **G.S.G SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA